



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO

**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO

---

**C-II.-18-0013-C0001**

*Paditësi:*

**F.L., Mitrovicë**

Kundër:

*E paditura*

**NSH në Mitrovicë**, të cilën e administron **Agjencia Kosovare e Privatizimit**, rr. “*Agim Ramadani*”, Nr. 23, Prishtinë.

Dhoma e Posaçme e Gjykatës Supreme të Kosovës për çështjet në lidhje me Agjencinë Kosovare të Privatizimit (Dhoma e Posaçme), gjyqtarja Teuta Ibrahim, më 23 shtator 2019, lëshon këtë:

**AKTVENDIM**

**Ankesa e Ankuesit hidhet poshtë si e papranueshme.**

**Rrethanat faktike dhe procedurale:**

Ankuesi është ish-punëtor i Ndërmarrjes Shoqërore – **NSH në Mitrovicë**. Data e privatizimit të Ndërmarrjes është 11 qershor 2013.

Lista e përkohshme e të punësuarve me të drejta legjitime ishte shpallur më 22 dhe 23 dhjetor 2017 dhe data e përfundimit të afatit për të parashtruar kërkesë ka qenë deri më 13 janar 2018.

Afati i fundit kohor për të parashtruar ankesë pranë Dhomës së Posaçme të Gjykatës Supreme kundër listës përfundimtare të punëtorëve ka qenë 28 korrik 2018.

Ankuesi ka parashtruar ankesë në Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme (DHPGJS) më 8 mars 2018, kundër Ndërmarrjes Shoqërore – **NSH në Mitrovicë**, e administruar nga Agjencia Kosovare e Privatizimit (AKP-ja).

Në ankesën e tij, ai kërkon të përfshihet në listën e punëtorëve për ndarjen e 20% nga të ardhurat pas privatizimit të NSH.

Ankuesi ankesës së tij i ka bashkëngjitur:

- letër konfirmimin e AKP-së të datës 21.02.2017;
- kopjen e pavërtetuar të librit amzë;
- kopjen e pavërtetuar të vendimit të Komunës së Skenderajt nr. 03/201/2407 të datës 01.03.2012 për ndërrimin e emrit;
- kopjen e pavërtetuar të raportit mjekësor për M.M.i datës 10.01.2018;
- kopjen e pavërtetuar të raportit mjekësor për M.M.i datës 20.01.2018;
- kopjen e pavërtetuar të vërtetimit mjekësor për shoqërimin e M.M.;

Më 5 prill 2018, AKP-ja parashtrori përgjigje ndaj ankesës së ankuesit. Agjencia pohon se për këtë NSH AKP-ja ende nuk e ka shpallur listën fillestare.

Më 13 prill 2018, Dhoma e Posaçme ia ka dërguar ankuesit përgjigjen e AKP-së.

Më 24 prill 2018, Dhoma e Posaçme ka pranuar një Parashtrësë nga ankuesi në të cilën thekson se nuk ka pasur mundësi të përcjellë gazetatat lidhur me shpalljen e listave preliminare dhe përfundimtare dhe kërkon që kjo ankesë të mbetet në fuqi ashtu siç është dorëzuar deri në publikimin e listës përfundimtare.

Në bazë të dokumenteve të dorëzuara dhe shqyrtimit të tyre Gjykata vlerëson se, ankesa është dorëzuar para afatit të paraparë.

Prandaj ankesa **hedhet poshtë si e papranueshme.**

#### **Arsyetimi ligjor:**

Vendimi lëshohet pa mbajtur seancë dëgjimore sepse faktet dhe provat e deponuara në lëndë janë mjaft të qarta, andaj gjyqtari individual nuk pret që në seancë të ketë më tepër informacione dhe argumente në kuptim të nenit 72 paragrafi 11 të Ligjit të DHPGJSK (Nr. 06 L-086).

Procedura për bërjen e ankesës, në Dhomën së Posaçme, është e caktuar me nenin 10.6 (a) të Rregullores së UNMIK-ut 2003/13 (të ndryshuar dhe të plotësuar), i cili cekë:

*“Ankesa duhet të dorëzohet në Dhomën e Posaçme brenda 20 ditëve pas shpalljes përfundimtare në media nga Agjencia, në bazë të paragrafit 10.3, të listës së të punësuarve me të drejta legjitime. Dhoma e Posaçme shqyrton çfarëdo ankesë në bazë të përparësisë dhe merr vendim për këto ankesa brenda 40 ditëve pas dorëzimit të tyre”;*

Ankuesi e ka parashtruar ankesën e tij para afatit dhe si e tillë është e papranueshme.

Më 27 korrik 2018 ankuesi F.L. ka parashtruar ankesën e tij pranë DHPGJS për çështje që lidhen me Agjencinë Kosovare të Privatizimit kundër listës së punëtorëve të Ndërmarrjes Shoqërore – NSH në Mitrovicë, në grup me ankuesit tjerë e regjistruar me numër të lëndës C-II.-18-0061. Në këtë lëndë ankuesi F.L. është i renditur me nr. C0003. Kjo ankesë është e afatshme dhe do të trajtohet në kuadër të ankesave si lëndë e përbashkët.

Lëshimi nga ana e ankuesve për të kontestuar listën e përkohshme, në bazë të nenit 72 paragrafi 2 të Ligjit për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme, nuk e bënë ankesën në listën përfundimtare të papranueshme.

Neni 127 i Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28 nuk mund të aplikohet në këtë procedurë. Neni 127 thekson:

*„Ankesa administrative 127.1, Ankesa administrative mundet bëhet në formë të kërkesës për rishqyrtim ose në formë të ankesës.*

*127.2. Secila palë e interesuar, ka të drejtë ankese, kundër aktit administrativ, ose kundër refuzimit të pa ligjsbëm për lëshimin e aktit administrativ.*

*127.3 Organi Administrativ, të cilit ankesa ju është dërguar, shqyrton ligjsbëmerinë dhe rregullsinë e aktit kontestues.*

*127.4 Palët e interesuara, mund ti drejtohen Gjykatës, vetëm pas shfrytëzimit të të gjitha mjeteve administrative të ankimit.“*

Por, edhe sikur neni 127 i Ligjit mbi Procedurën Administrative nr. 02/L-28 të aplikohet, nuk do të ishte e nevojshme që ankuesit të kontestojnë, listën e përkohshme, para paralajmërimit të ankesës në listën përfundimtare. Kërkesa e tyre nuk ka të bëjë me listën e përkohshme (i cili ka mundur të jetë i kontestuar), përveç në listën përfundimtare (kundër të cilës mjete juridik në procedurën administrative, nuk është i mundur).

Përveç kësaj, formulimi i fjalisë së parë, neni 72 paragrafi 2 i Ligjit të DHPGJSK (Nr. 06 L-086).nuk mund të interpretohet, ashtu që të punësuarit duhet të kontestojnë listën e përkohshme, për të pasur të drejtë, që më vonë të ankohet në listën përfundimtare.

*“Pas pranimit të listës së të punësuarve me të drejta legjitime në bazë të nenit 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13, apo në bazë të çfarëdo legjislacioni pasues që rregullon krijimin e një liste të tillë, Agjencia shpallë listën së bashku me njoftimin për qytetarët mbi të drejtat e personit për të parashtruar një ankesë në Agjenci brenda njëzetë (20) ditëve pas datës së shpalljes, duke kërkuar përfshirjen në një listë të tillë dhe/ apo duke sfiduar përfshirjen e një apo më shumë personave tjerë në një listë të tillë”.*

Për arsye të lartcekur gjykata nuk është lëshuar fare në merita lidhur me këtë çështje

Andaj, për arsye të cituar më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij Aktvendimi.

### **Taksa Gjyqësore**

Vendimi nr. 25 i Këshillit Gjyqësor të Kosovës, i lëshuar me 05 mars 2014, miratoi tabelën e taksave gjyqësore për Dhomën e Posaçme të Gjykatës Supreme të Kosovës, për kolegjin e specializuar pika 2 parashihet që:

*Paditë dhe çështjet tjera që ndërlidhen me të drejtat e punëtorëve në nenin 10 të Rregullores së UNMIK-ut nr. 2003/13 ose çfarëdo legjislacioni të mëvonshëm që merret me ato të drejta; 50 euro për çdo ankesë, me pagesën maksimale për çdo lëndë prej 500 euro; Punëtorët lirohen nga pagesat.*

Kjo është arsyeja pse në këtë lëndë që ka të bëjë me lista të punëtorëve, është liruar nga pagesa e taksave gjyqësore.

### **Këshillë Juridike**

Kundër këtij aktvendimi mund të parashtrohet ankesë me shkrim në Kolegjin e Apelit të Dhomës së Posaçme brenda 15 ditësh nga pranimi i këtij aktvendimi. Ankesa duhet të dorëzohet në bazë të nenit 9 paragrafi 6 të Ligjit për Dhomën e Posaçme.

**Teuta Ibrahim** – Gjyqtare \_\_\_\_\_